



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2018

**V E N D I M**

**Nr. 14 , Datë 11 / 01 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. Regj.165, datë 20.12.2017, të z.E. N, kundër Bashkisë Gjirokastër, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”, “*të gjendjes ekonomike*” dhe “*të racës*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I :**

Bazuar në deklaratimet e z.E. N ai jeton në një banesë prej dy dhomash dhe një kuzhinë me gruan dhe 6(gjashtë) fëmijët e tij. Djali i madh është 52 vjeç dhe më i vogli 37 vjeç. Z.E. N shprehet se: “*...Kam kërkuar zgjerim prej 35 vitesh, por nga ana e Bashkisë Gjirokastër nuk është marrë asnjë masë. Janë ndarë disa shtëpi, ndërsa mua nuk më kanë dhënë pasi më kanë thënë që bindja ime politike është ndryshe nga e tyre (Bashkisë Gjirokastër). Të ardhurat tona janë vetëm dy pensione. Djali i vogël ka mbaruar studimet e larta dhe është pa punë*”.

Për sa më sipër, ankuesi kërkon nga Komisioneri, ti zgjidhë problemin e strehimit dhe të punësimit të djalit të tij, R. N.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, lidhur me shkaqet e pretenduara prej tij.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Për këtë arsye, me datë 22.12.2017, i është dërguar e-mail Specialistes së Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gjirokastrë, ku i është kërkuar të kontaktojë ankuesin (për të lehtësuar aksesin e ankuesit pranë KMD-së, nisur dhe nga mosha e subjektit ankues<sup>2</sup>) dhe t'i kërkojë të paraqesë dokumentet provues për pretendimin e tij, (lidhur me shkaqet e pretenduara), meqenëse ankuesi nuk i ka bashkëngjitur ankesës dokumentet shkresore që t'i provojë ato dhe as ka parashtruar argumentime lidhur me këtë fakt.

Përsa më lart, me datë 27.12.2017 Specialistja e Zyrës Rajonale të KMD-së, Gjirokastrë, informon Komisionerin se zotëria nuk pranon të sjellë dokumentacion provues për shkaqet për të cilat pretendon diskriminim nga ana e Bashkisë Gjirokastrë. Po ashtu, bashkëlidhur e-mailit dërgoi dhe një kopje të Çertifikatës familjare aktuale të z.E. N.

Referuar kësaj të fundit, në përbërjen familjare të z.N figurojnë 4 anëtarë gjithsej: z.N, bashkëshortja dhe dy djemtë e tij A dhe A. N. Pra, referuar dokumentit zyrtar të Zyrës së Gjendjes Civile Gjirokastrë, z.E. N është kryefamiljar dhe jeton me gruan dhe dy prej djemve dhe jo me 6 (gjashtë) fëmijët e tij, gjë që nuk përjashton faktin se realisht në banesë mund të banojnë 8 (tetë) persona: z.N, bashkëshortja dhe 6 (gjashtë) fëmijët e tij.

Katër fëmijët që nga dokumentacioni nuk rezultojnë të jetojnë me z.E. N, janë të gjithë në moshë madhore dhe kryefamiljarë të vetëm<sup>3</sup>, për rrjedhojë duhet të paraqesin kërkesë për strehim pranë Bashkisë Gjirokastrë në emër të tyre dhe jo babai në emër të tyre.

Ankuesi nuk solli asnjë përgjigje, dokument, provë apo parashtrim ku të shpjegonte apo mbështeste pretendimet e tij lidhur me shkaqet e pretenduara: bindjet politike, gjendjen ekonomike apo racën.

---

<sup>2</sup> Referuar dokumentit të identifikimit ankuesi është i datëlindjes 06.03.1938.

<sup>3</sup> Referuar dokumentit të Bashkisë Gjirokastrë me nr.extra prot., datë 27.12.2017.

Referuar dokumentacionit, rezultojnë se:

- Znj.I. N është e datëlindjes 03.02.1964.
- Z.R. N është i datëlindjes 14.04.1966.
- Znj.M. N është e datëlindjes 08.03.1970.
- Z.R. N është i datëlindjes 22.06.1982.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të provohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Lidhur me sa më sipër, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë për të provuar lidhjen shkakësore për diskriminimin e tij nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, për shkaqet e pretenduara.

Bazuar në nenin 33, pika 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Po ashtu, lidhur me pretendimin e punësimit të djalit të tij, Komisioneri i rekomandon subjektit ankues, që z.R. N të paraqitet pranë Zyrës Rajonale së Punësimit Gjirokastrë apo të aplikojë personalisht për punë, pasi nuk mund të legjitimohet i ati, z.E. N të aplikojë në emër të tij. (Përveç rasteve që janë parashikuar me ligj, në tagrin e përfaqësuesit ligjor). Në rast se ndonjë nga fëmijët e z.N ndihet i diskriminuar nga cilindo institucion publik dhe do të ankohet personalisht për ndonjë nga shkaqet e parashikuara në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duhet të paraqesë para KMD-së ankesë individuale.

Referuar nenit 21, pika 1 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 33, pika 4/b/ç, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së z.E. N, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

Fusha: Shërbime

Shkaku: